**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASENIT LUMOR SEMAN**

ZYRA E ADMINISTRIMIT
TË BASENIT LUMOR
SHKUMBIN-SEMAN
Nr. 472 Prot.
Datë,më 04.06.2026

**VENDIM**

**Nr.8, datë 28.05.2026**

**PËR**

# MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË AMBALAZHUAR, TË SUBJEKTIT "LEA 2017" SH.P.K, ME VENDNDODHJE: FSHATI RADOSTINË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DERMENAS, BASHKIA FIER.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, *"Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre"*, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Seman,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës "Për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar, në rastin kur përdorimi është për <= 150 shishe/orë, <= 1 l/s", të subjektit "LEA 2017" sh.p.k, me vendndodhje: Fshati Radostinë, Njësia Administrative Dermenas, Bashkia Fier.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

   Akuiferi: ***Depozitimet e Kuaternarit.***

   Vendndodhja e burimit ujor (pus-shpimi) (KRGJSH):

   **X=459329; Y=4510762.08; Z=10 m.m.n.d**

   Vendndodhja e pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH):

   **X=459329.54; Y=4510747.05; Z=10 m.m.n.d**

   Prurja e ujit të kërkuar: **0.5 l/s**

Thellësia e pus-shpimit: **90m**

Qëllimi i përdorimit të burimit ujor: **Për ujë të ambalazhuar.**

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

**X=459338.57; Y=4510787.59; Z=9.6 m.m.n.d**

Sasia e ujit të shkarkuar: **0.01 l/s**

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

**KRYETARI I KBL SEMAN**

**ANDUEL XHINDI**